



Trinia në perspektivën myslimane: Një Perspektivë Myslimane

## Description

**Tim Winter**

© websiti [erasmusi.org](http://erasmusi.org)

**(Teksti i një leksioni të dhënë së fundmi para një grupi të krishterësh në Oksford, 1996)**

**Çdo përshfaqje e kuptimeve myslimane rreth Trinisë do të rrethohet nga një mori vështirësish.** Jo vogli prej tyre është fakti se këto kuptime myslimane kanë qenë pothuajse po aq të ndryshme dhe të numëroshme sa ato të rrënjësura në mesin e vetë studiuesve të krishterë. Është e vërtetë se Islami mesjetar kishte njohje të mëdha rreth doktrinës së krishterë nga ç'dinin doktorët e Kishës rreth Islamit, për arsyt e qartë seshoqë myslimane përmbanin në gjirin e tyre pakica të kënduara me të cilat mund të debatohej, gjë që zakonisht t'ndodhte në Botën e Krishterë. Dialogu myslimano-i-krishterë, një risi në perëndim, ka një historitë gjatë r Lindjen e Mesme, e cila daton të paktën sa debatet e mirësjellja ndërmjet Shën Gjonit të Damaskut dhe dijetarëve myslimanë të Sirisë së shekullit të shtatë. Dhe megjithatë duke lexuar teologët tanë, diletrëndon konkluzionin se shumica e tyre pothuajse asnjëherë nuk e 'rrokën' thelbin e Trinisë. Analiza e tyre mund të kritikohet mbi bazat e, jo të mungesës së sofistikutimit, por familjaritetit të pamjaftueshëm me kompleksitetet menduarit trinitar skolastik apo lindor. Ndonjëherë ata thjesht u qëllojnë me heshtëmullinjëve të erës.

Mendoj se kjo ka patur dy arsye. Së pari, doktrina e Trinisë ishte pika më nevralgjike e diskutimit ndërmjet Krishterimit dhe Islamit dhe rrjedhimisht, që e ngarkuar me ndjenja të forta. Për mendjen myslimane paramoderne, pushtuesit, kryqëtarët, inkuizitorët dhe të tjerët e krishterë ishin kryesisht të obsesionuar me idenë për t'ua imponuar doktrinën e Trinisë armiqëve ditëzinj myslimanë. Edhe sot në mesin e myslimanëve Rusi mbahet mend se kur Ivani i Tmerrshëm zaptoi Kazanin, kryeqytetin e myslimanëve të Vollgës, ai u t' njerëzve atje se ata mund t'u shpëtonin tehtë të shpatës me anë 'të të lavdëruarit me ne të Trinisë Më tëE brez pas brezi'. Edhe sot në Bosnje, çetnikët serbë përdorin përshendetjen e tyre të Trinisë me trigishta s sfide ndaj armiqëve myslimanë. E kështu me radhë. Pjesa më e madhe e të teologjizuaritmysliman rreth është vendosur, pra, në një kontekst të hidhur polemike të frikës dhe shpeshherë të urrejtjes së hapur: Tr si simboli i tjetrit të panjohur por mizor që rri e përgjon në brigjet veriore barbare të Mesdheut, skenë kjo e lloj çudie dhe mizorie djallëzore.

Mendoj se këtij shtrembërimi i shtohen disa probleme që parashtrojnë doktrina e Trinisë në vetvete. Islami, ndërkohë që ka prodhuar mendimtarë të mëdhenj, ka vendosur megjithatë më pak vezë epistemologjike shportën teologjike nga ç'ka bërë krishterimi. Ndërsa lexohen paraqitjet myslimane të Trinisë nuk mundet vetëm se të pikaset një sens padurimi. Një nga virtytet e ndërgegjes së tipit semit është bindja se realiteti përfundimtar duhet të jetë përfundimisht i thjeshtë, dhe se e folura nikease e një hyjnie me tre persona, në të cilëve ka dy natyra por që të gjithë janë të reduktueshëm deri diku në unitet autentik, pa qenë aspak racionalisht të dyshimtë, duket intuitivisht e gabuar. Zoti, themeli i fundëm i të gjithë qënies, sigurisht nuk përse të jetë kaq i ndërlikuar.

Këto dy pengesa drejt një të kuptuari korrekt të Trinisë jetojnë deri në një farë mase edhe sot. Por një per e re është shfaqur aty gjatë shekullit të kaluar meqënëse konsensusi i vjetër Kishero Perëndimor mbi atë ç'do të thonte Trinitet, i cili ngahera ishte një konsensus i brishtë, duket se nuk preferohet më nga shumë studiues seriozë të krishterë. Duke analizuar korpusin dhe vrullin mbresëlënës të prodhimit teologjik të krishterë, myslimanëve mund t'u duket e vështirë të mësojnë saktësisht se si e kuptojnë shumica e të krishterëve Trinitetin. Gjithashtu është pjesë e përvojës sonë që të krishterët janë zakonisht më të prirur t' debatojnë tema të tjera; dhe ne priremi të dalim në konkluzionin se kjo ndodh meqënëse ata vetë nuk ndi komod me disa aspekte të teologjisë së tyre trinitariane.

---

Ajo që unë do të përpiqem të bëj, pra, është të ekspozoj kuptimin tim personal, si mysliman, në lidhje me doktrinën trinitariane. Unë do ta filloja duke e bërë të qartë se e pranoj që këtu vihet shumëçka në diskutim ortodoksia historike e krishterë. Doktrina e fundamentale e Trinisë nuk ka asnjë sens nëse nuk pranohen gjithashtu edhe doktrinat e mishërimit dhe ajo e shlyerjes (paqimit mes Zotit dhe njerëzimit nëpërmjet vde

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi